

Strasbourg, 20 Nëntor 2015

## ***KËSHILLI KONSULTATIV I PROKURORËVE TË EUROPËS ( CCPE)***

### ***Deklaratë***

---

Të tronditur nga numri dhe ashpërsia e sulmeve të fundit terroriste në mbarë botën;

Duke shprehur dhembshuri të thellë me viktimat e këtyre sulmeve dhe solidaritetin me familjet e tyre;

Duke pasur parasysh se terrorizmi është një kërcënim i rëndë për demokracinë, lirinë dhe të drejtat e njeriut;

Duke ritheksuar se prokurorët janë në vijën e parë të frontit për të luftuar terrorizmin në kuadër të kompetencave të tyre dhe duke theksuar vendosmërinë e tyre për të bërë përpjekje maksimale për të siguruar respekt kundrejt jetës, sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut;

Këshilli Konsultativ i Prokurorëve të Europës (CCPE):

1. Bën thirrje prokurorëve për të përmirësuar luftën e tyre kundër terrorizmit duke rritur bashkëpunimin e tyre ndërkombëtar, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe duke promovuar kontaktet efektive ndërmjet autoriteteve kompetente;

2. Bën thirrje prokurorëve të të gjitha Shteteve anëtare, ndërsa luftojnë kundër terrorizmit, të veprojnë në përputhje me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
3. Nxit Shtetet anëtare të sigurojnë mënyrat e nevojshme për hetimet dhe ndjekjet penale dhe të marrin në konsideratë kornizat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe trajnim të specializuar për prokurorët, për ndalimin e kërcënimit të rëndë ndaj terrorizmit;
4. U bën thirrje Shteteve anëtare të ratifikojnë protokollin shtesë të Konventës të Këshillit të Europës për Parandalimin e Terrorizmit ( STCE No.217).